

VENDIM
Nr.9, datë 5.6.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv/kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Veli Budo	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Thimjo Kondi	Anëtar	i Gjykatës Kushtetuese
Natasha Sheshi	Anëtare	e Gjykatës Kushtetuese

me sekretare Drita Filto, më datën 2.6.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

kërkues: Këshilli Bashkiak i Rrethit Shkodër

OBJEKTI

Interpretimi i nenit 40 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

GJYKATA KUSHTETUESE,

Pasi dëgjoi relacionin përkatës,

VËREN:

Me kërkesën Nr.797, datë 21.04.1993, Këshilli Bashkiak i rrethit Shkodër, duke marrë shkas prej Urdhërit Nr.1, datë 06.04.1993, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të cilin e konsideron në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, kërkon prej Gjykatës Kushtetuese interpretimin e nenit 40 të Ligjit Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Rrethanat në të cilat është nxjerrë urdhëri i Ministrit të sipërpërmendur janë si më poshtë:

Dega e Policisë Financiare e rrethit Shkodër, me vendimin Nr.23, datë 02.03.1993, bazuar në nenin 5 të dekretit Nr.7463, datë 31.01.1991 "Për Policinë Financiare", ka vendosur sekuestrimin e makinës tip "Benz", të shtetasit Gj.B. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin Nr.1069/3, datë 24.03.1993 të Drejtorisë së Policisë Financiare.

Ministri i Financave me Urdhërin Nr.1, datë 06.04.1993, ka vendosur prishjen e vendimit të Policisë Financiare dhe kthimin e automjetit pronarit të tij, si dhe lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.

Urdhëri i atakuar i Ministrit të Financave bazohet në nenin 40 të Ligjit Nr.7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", sipas të cilit: "Ministrat shfuqizojnë urdhërat e udhëzimet e paligjshme të organeve, të ndërmarrjeve e të institucioneve që varen prej tyre".

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, arrin në përfundimet si më poshtë:

është e vërtetë se, sipas nenit 2 të dekretit Nr.7463, datë 31.01.1991 "Për Policinë Financiare", Policia Financiare organizohet dhe drejtohet nga ministri i Financave", por, sipas paragrafit të fundit të nenit 5 të këtij dekreti, "Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te kryetari i degës së policisë financiare të rrethit a të rajonit ose te drejtori i Drejtorisë së Policisë Financiare në Ministrinë e Financave, akti i të cilëve është i formës së prerë".

është e vërtetë se dispozitat e mësipërme janë të karakterit ligjor dhe si të tilla, ato nuk mund të kenë fuqi juridike më të lartë, as edhe të barabartë, me nenin 40 të ligjit kushtetues në fuqi, por një problem i tillë nuk shtrohet, sepse objekti i rregullimit të normave ligjore të lartpërmendura është i ndryshëm nga ai i normës kushtetuese (neni 40). Normat ligjore të dekretit për policinë financiare parashikojnë përgjegjësinë administrative të subjekteve fajtorë, rregullat e gjykimit administrativ dhe karakterin e vendimeve që merren, ndërsa norma kushtetuese në fjalë parashikon të drejtën e ministrave për të shfuqizuar urdhërat e udhëzimet e paligjshme të organizmave që varen prej tyre, të cilat kanë karakterin e akteve normative apo të akteve ekzekutive. Pra, në normën kushtetuese objekt interpretimi nuk përmenden, dhe s'kishte si të përmendeshin, vendimet e organeve të caktuara nga ligje të posaçme për gjykimin e kundërvajtjeve administrative.

Si përfundim, Ministri i Financave, duke urdhëruar prishjen e një vendimi të formës së prerë të Drejtorisë së Policisë Financiare, ka kapërcyer përmbajtjen e nenit 40 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", prandaj urdhëri i tij konsiderohet antikushtetues.

Në këto kushte, personat që pretendojnë shkelje të të drejtave nga organet e gjykimit administrativ, të caktuara me normë ligjore të veçantë, nuk investojnë organe më të larta ekzekutive, por ata, kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të tyre, në rrugë gjyqësore, duke vepruar në pajtim me nenet 38, 39 dhe 40 të ligjit kushtetues Nr.7692, datë 31.03.1993 (Kreu "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut").

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash, në bazë të nenit 24, pika 1 dhe 25, paragrafi i dytë të ligjit "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

VENDOSI:

Ministrat nuk kanë të drejtë të shqyrtojnë bazueshmërinë ligjore të vendimeve të organeve të caktuara me ligj për gjykimin e kundërvajtjeve administrative.

Ky vendim është në fuqi ditën e shpalljes së tij.